



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **KUVENDI I KOMUNËS**

**Procesverbal i mbajtur më 08 prill 2021, në mbledhjen e XLVI (dyzet e gjashtë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.**

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Blerim Maqastena, i arrestuar, ndaluar dhe i paraburgosur në shtetin e Serbisë, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DA, DKRS, DBF, DPZHE DPKGJ, DSHPMSh, DBPZHR, DSHMS) të Komunës së Podujevës, përfaqësues të OJQ – DFK, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i zyrtarëve komunal.

**z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë seancë e cila po ashtu është duke u mbajtur në situatë jo të zakonshme për shkak të pandemisë covid-19 për çka kërkoj të respektohen masat. Kuorumi për punë dhe vendimmarrje ekziston andaj mund të vazhdojmë me punë në këtë seancë, materialet gjithashtu i keni marrë me kohë përshtirë edhe rendin e ditës dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, kam lexuar rendin e ditës dhe ne si Grup nga LVV-ja e respektojmë mendimin e Komitetit për Politikë dhe Financa por jemi të mendimit që rregullorja që rregullon organizimin e fshatrave të jetë sot në rend të ditës në mënyrë që të vëhet në diskutim publik, kjo për shumë arsye, e para rregullorja në fjalë është shumë e rëndësishme për Komunën ton sepse jemi prej komunave të pakta që nuk kemi organizim ligjor për këtë çështje, e dyta ndihmon direkt qytetarin që të merr pjesë në vendimmarrje e një anashkalim i tillë nuk është në rregull edhe ligjërisht edhe moralisht por edhe në aspektin e funksionalitetit të demokracisë lokale. E lexova me vëmendje edhe pikat se kur duhet të mbahen dëgjimet publike, e di që janë mbajtur dëgjime publike edhe në kushte pandemike, andaj për dy muaj kohë që u propozua do të thotë se në momentin që të ofrohen kushtet dhe rrethanat që të fillohet me debate publike ngase nuk mundemi t'i mbajmë 5 në këtë situatë pandemike por mund t'i mbajmë 2 në zona periferike duke pasur parasysh faktin që pjesa më e madhe e popullsisë jeton në zona rurale dhe një në zonë lokale, është kohë vere dhe mund t'i respektojmë masat anti-covid, prandaj unë propozoj që kjo pikë të mos hiqet nga rendi i ditës por të vazhdohet t'i mundësohet kësaj rregulloreje që të kalojë në debat.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, unë e morra fjalën vetëm për ta plotësuar kolegun dhe për hir të korrektësisë edhe ndaj qytetareve dhe kolegeve të tjerë të cilët nuk janë anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, në momentin që kemi ardhur tek kjo pikë e rendit të ditës të gjitha Grupet e këshilltarëve e kemi shprehur gatishmërinë tonë që një rregullore e tillë jo që është ndoshta me nguti por përkundrazi është e vonuar si e tillë, mirëpo pas një debati shumë konstruktiv brenda gjitha Grupeve të këshilltarëve, shtu këtu edhe konstruktivitetin e drejtorit të Drejtorisë përkatëse, ne kemi

ardhur në përfundimin që, madje për ta sqaruar këtë ka qenë propozim konkret i Grupit të këshilltareve të LVV-së se për hir të mbrojtjes së shëndetit publik dhe për hir të situatës aktuale dhe masave që janë marr sa i përket situatës së krijuar pandemike, kjo pikë të shtyhet për një seancë të radhës. Nuk e di përse është më e arsyeshme ne të japim një para-autorizim Drejtorisë kurse ne mund të presim datën 18 dhe të shohim se si do të jetë situata tutje me masat dhe nëse nuk ka masa atëherë ne mundemi edhe ta thërrasim një seancë të jashtëzakonshme dhe t'i japim dritën jeshile kësaj rregulloreje që të procedohet tutje.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket pikës që u ngrit tani është e vërtetë që dje në mbledhjen e KPF-së kemi marr qëndrim që të shtyhet me një anonimitet të të gjitha Grupeve të këshilltarëve, faktikisht për shtyrjen e kësaj pike çështja është ngritë nga Grupi i PDK-së. Sa i përket kësaj pike, i nderuar Kryesues ne i kemi shterur debatet në mbledhjen e KPF-së dhe kemi votuar që të shtyhet kjo pikë edhe me propozimin e Grupit të këshilltarëve të LVV-së.

Sa i përket diskutimeve, unë i dëgjova parafolësit dhe siç tha z.Ragip Fetahu që mund t'i bëjmë 3 tubime e jo 5, unë e them se debatet publike duhet të mbahen ashtu siç i parasheh Udhëzimi Administrativ, është e vërtetë që kjo rregullore është kërkuar edhe nga ne por edhe nga grupet tjera por nuk është funksionalizuar në kohën kur ka pasur mundësi dhe është shtyrë për çështje politike. Çështja tjetër, sa i përket Grupit të PDK-së janë organizuar debate publike për këtë çështje edhe nga shoqëritë civile e që edhe në mbledhjen e kaluar e ceka që askush nga Kuvendi apo Ekzekutivi nuk ka marr pjesë në ato debate të mbajtura në restorant "Artela" debatet në të cilat unë kam qenë prezent si asamblistë, kam pasur ftesë por nuk ka qenë askush edhe nuk ka dashur askush të merret me këtë çështje. Sa i përket çështjes që kemi diskutuar dhe kemi kërkuar të shtyhet kjo pikë, atë e kemi thënë për shkak të rrethanave të gjendjes që kemi nga pandemia dhe masat e marra.

Sa i përket çështjes së rregullores jemi pro që kjo duhet të ecë përpara, mirëpo unë edhe në mbledhjen e kaluar kam shtruar pyetje dhe askush nuk ka munduar të japë përgjigje rreth mbajtjes së debateve publike në këto rrethana që jemi, situatë e cila siç duket do të zgjatë edhe më tutje.

Nëse marrim vendim për ta vënë në diskutim publik këtë rregullore, e njëjta do të qëndroj gjatë në dëgjim publik, madje madje për këtë rregullore mund të themi se po marrim vendim por nuk do të funksionalizohet hiq në këtë përbërje të Kuvendit që është, por këtë Rregullore mund ta funksionalizoj një qeverisje dhe Kuvend i ardhshëm për arsye se nuk ka kohë. Gjithashtu kemi dëgjuar edhe ekspertët e kësaj fushe, unë kam folur në aspektin ligjor si jurist por kemi dëgjuar edhe mendimet e sektorit të shëndetësisë edhe nga qeverisja e LVV-së që vie nga ai sektor dhe ndoshta edhe KPF e ka mbështet qëndrimin ton që të shtyhet kjo pikë.

Çështja tjetër, unë edhe në mbledhjen e kaluar e thash këtu se është bërë një praktikë jo e mirë e propozuesve që vijnë në pushtet, nga cilido subjekt politik qofshin ata, që kur propozojnë diçka dhe nuk kalon këmbëngulin në çdo formë që të kaloj aji çështje kurse nuk e kanë të rëndësishme a kalon mirë apo nuk kalon, apo ka qenë një mos koordinim në mes të Grupit të kuvendarëve të LVV-së dhe Ekzekutivit. Është mirë që ta dëgjojmë edhe drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe i njëjti të na jap një mendim sepse jemi në situatë pandemie dhe duhet maturi, dhe të cilin unë e kam pyetur se qysh mendon t'i mbajë debatet publike me qytetarë. Jemi në, dijeni se mund të organizohen debate publike virtuale.

Kuvendi ka për ta ngritur një komision prej 7 anëtarëve për implementimin e kësaj rregulloreje, vendimi i Qeverisë është që në tubime mbi 10 persona nuk guxon të mblidhen, e këtu tani që dikush po (i bie tupanit) se i respekton ligjet dhe vendimet, kurse në anën tjetër të veprohet diçka që është në kundërshtim me ligjin, kjo për mua është shumë skeptike, ndërsa a duhet t'i zbatojmë vendimet e Institucionit, çoftë të nivelit lokal çoftë qendror, e që për mua ka shumë pak rëndësi kush është aty ulur sepse e shoh që është ulur institucioni, e që ne duhet të mësohemi një here e përgjithmonë që të

respektojmë institucionin e jo individin, prandaj e them se shumë pak ka rëndësi çka thotë këtu dikush individualisht. Kështu që tani është mirë ta dëgjojmë edhe Grupin e LVV-së pse ishte për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës kurse sot ka qëndrim të kundërt, unë e kam jap arsyeshmërin time për këtë pikë në KPF edhe në emër të Grupit të PDK-së por edhe si këshilltarë i Kuvendit, prandaj e them që është mirë edhe dikush nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së, jo nga Ekzekutivi sepse Ekzekutivi e ka sjell që të kaloj kjo pikë, pra nga LVV dikush të na tregoj përse për një kohë shumë të shkurtër dy qëndrime të kundërta.

**znj.Doruntina Hasni**, theksoi, për ta plotësuar z.Rafet Llapashtica, kurdo që kemi qenë të thirrur në debate publike sa i përket kësaj rregulloreje kemi qenë të pranishëm, ndoshta ju keni harruar por pa ardhur kjo rregullore në Kuvendin komunal gjithmonë ndoshta pjesa më e madhe kanë qenë për ta shtyrë, ne kemi qenë për të vazhduar kjo rregullore, madje edhe në atë kohë kam paraqitur mënyra kreative se si mund të organizohen dhe mbahen debatet publike. E dimë që debatet publike deri më tani janë bërë në atë mënyrë që nuk kanë pasur shumë efekte, janë mbajtur me shumë pak persona dhe në kohë të pa përshtatshme, janë bërë gjatë ditëve të punës ku iu është pamundësuar shumicës së qytetarëve që të jenë prezent, kështu që unë mendoj që jo vetëm që është pandemi por mënyra e organizimit të debateve publike duhet të ndryshoj.

Nuk duhet me qenë kjo shtyrje e kësaj pike të rendit të ditës, nuk e di çfarë është diskutuar në KPF, por nuk mendoj që duhet të vazhdoj të mos procedohet tutje me këtë rregullore sepse nuk e dimë edhe sa do të vazhdoj kjo pandemi, ka mënyra të ndryshme të mbajtjes së debateve publike, madje sa jam në dijeni buxheti i shumicave të komunave është miratuar në mënyrë virtuale përmes teknologjisë, prandaj e them se duhet të mbështetet kjo që të vazhdohet me këtë pikë të rendit të ditës, për arsye se kemi mënyra të ndryshme që mundet të vazhdoj.

Çështja tjetër është se unë po mendoj që po bëhen shumë diskutime, ndoshta kjo po ndodh për shkak të kohës së shkurtër mes dy mbledhjeve, asaj të KPF-së dhe Kuvendit, e që unë konsideroj se KPF duhet të mbahet më herët dhe duhet para thirrjes së seancës së Kuvendit gjë të cilën e bëjnë shumica e Komunave tjera, besoj që kjo praktikë duhet të hiqet edhe nga Komuna e Podujevës.

**z.Fatmir Gashi**, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket asaj që i potencua se ne nuk dihet çfarë është diskutuar në KPF, rekomandimin e keni para vetës, pra rreth temës në fjalë është diskutuar, debatuar dhe sponsorizuar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Administratës, ka hyrë në rend të ditës. Unë dhe Kryetari i Komunës e kemi caktuar dhe vendosë rendin e ditës, aty është konstatuar që për shkak të rrethanave shtesë që janë marr tani e tutje mund të procedohet. Dëgjove pak me herët edhe shefat e Grupeve të subjekteve përkatëse, dëgjova edhe z.Ragip Fetahu në emër të Grupit të LVV-së, por megjithatë rekomandimi ka ardhur unanimitet nga KPF që kjo propozim rregullore duhet të shtyhet për një mbledhje të ardhshme, prandaj dua të them se konstatimet i kemi secili para vetës dhe mund të lexohen.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, dëgjova me vëmendje edhe kolegen, unë mendoj që është bërë një lëshim i vogël aty edhe prej Grupit tonë për shkak se data të cilën e ka vendosur Drejtoria e Administratës është nga data 19 me mundësi të fillimit të debateve publike dhe po e shohim që me kalimin e kohës situata covid-19 po ndryshon për të mirë dhe jemi në periudhë vere.

Unë personalisht kur e kam parë këtë rregullore jam gëzuar jashtëzakonisht shumë sepse e njoh funksionimin e politikave lokale dhe e di se ku qëndrojmë ne si Komunë dhe mendoj që është shumë e arsyeshme kjo sepse as nuk ka të bëjë me asnjë subjekt politik por ka të bëjë me interesin dhe përfshirjen e qytetareve në vendimmarrje dhe në politik bërje, prandaj mendoj që është shumë e rëndësishme t'i jepet drita e gjelbër kësaj draft Rregullore, jo në interes timin as në interes të Kryetarit, as në interes të Ekzekutivit, por në interes të qytetareve, dhe në momentin që i shohim se janë plotësuar kushtet dhe rrethanat të mbahen 3 debate publike 2 në zona periferike 1 në qytet dhe

të ecim tutje sepse vërtetë jemi prej komunave të pakta që nuk e kemi këtë organizim, në fakt e kemi por nuk është funksional.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, pa qare po duhet të diskutojmë rreth kësaj çështje edhe pse nuk ja vlen të diskutohet gjatë, problemi është me qëndrimin e opozitës, me theks LVV-së kjo propozim rregullore në seancën e 20 shtatorit 2020 është shtyrë, LDK dhe z.Nexhmi Rudari e ka sjell në Kuvend por është shtyrë për shkak të rrethanave, dhe për këtë i kemi procesverbalet. Arsyeja shumë këmbëngulëse ka qenë se është në kohë zgjedhjeve, i nderuar koleg Ragip Fetahu unë e kuptoj dhe e di që një pjesë e asamblistëve kanë qëndrime personale dhe shumë të drejta, për këtë çështje lufta nuk është zhvilluar a po bëhet rregullorja apo jo, por kush po i zgjedh këshillat e fshatrave dhe ky ka qenë problemi kryesor, kurse këtu nuk po diskutohet ashtu, prandaj konsideroj se kuvendarët duhet ta diskutojnë dhe të kryejnë detyrën e Kuvendit, ndërsa Ekzekutivi ta kryej punën e tij sepse jemi organe të ndara. Sa i përket asaj që u tha se rrethanat dhe situata nga covid-19 janë shumë më lehtësuese, jo nuk mendoj ashtu, përkundrazi situata është më e rënduar, jemi mbyllur deri me 18 prill 2021, kemi masa rigorozë, kurse në muajin shtator 2020 gjendja dhe numri i të infektuarve dhe të vdekurve në Podujevë ka qenë shumë me i vogël se që është tani. Pra problemi këtu është se kush po e bënë këtë Rregullore, fundja ta bënë kush të dojë, nëse është dashur ta bëjë atëherë është dashur LVV-ja në shtator 2020 ta përfundoj këtë rregullore në mënyrë që sot të jetë në funksion por keni propozuar vetë ju që kjo të shtyhet ndërsa tani e keni sjell në rrethana ende ma rënduese. Debatet publike nuk mund të mbahen. Ne duhet të merremi edhe me çështjet buxhetore që u ndërlihd kjo temë edhe pse buxheti është diçka tjetër kjo draft Rregullore është diçka tjetër.

Nuk mund të amnistohet për këtë çështje as Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, ky këtu ka qenë drejtor e anëtar i LDK-se para teje zotëri Ragip Fetahu, kryetarët e fshatrave janë zgjedh në mënyrë politike, për këtë nuk po e amnistoj as subjektin që i takoj sepse secili subjekt ku e ka pasur pushtetin dikund e ka bërë një gjë të tillë, dhe a e dini pse bëhen këto, sepse nuk ka njeri që del dhe të thotë jo edhe brenda organizatës politike, sepse paraprakisht duhet ta thirr dikën në telefon dhe ta pyes se çka me bë, e atëherë le të shikojnë më shumë secili subjekt për mos me u ballafaquar.

Prandaj për fund, unë po propozoj diçka, ndërsa për këtë të del në foltore dhe ta arsyetoj qoftë drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale qoftë Kryetari i Komunës, ta marrin përgjegjësinë për thirrjen publike për tubime, unë do ta votoj, pra të na sqaroj Drejtori i Shëndetësisë në aspektin shëndetësorë se a mund të mbahen debate publike, si mund ta bëhen, pastaj këtu prezent është edhe Kryetari dhe Nënkryetarja e Komunës, dhe unë publikisht do ta ngriti dorën për diçka që është në rregull, mirëpo mendoj se këtë përgjegjësi nuk mund ta marr askush, të vetmen përgjegjësi mund ta marrim ne sepse vet drejtori i drejtorisë së administratës ka kërkuar autorizim që debatet publike të mbahen deri në muajin gusht kurse ne në atë muaj jemi në pushim si Kuvend, prandaj për këtë arsye është shtyrë kjo, por nëse vije gjendja duke u përmirësuar hiqet vendimi i Qeverisë, në muajin tjetër le ta sjellë sërish dhe do ta votojmë pa kurrfarë problemi.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, theksoi, më duket u stërzgjatë paksa shumë kjo çështje, ndoshta pa ndonjë arsye të madhe sepse edhe në mbledhjen e KPF-së por edhe sot u munduam ta sqarojmë arsyen pse ka insistim që kjo rregullore të hyjë në rend të ditës.

E para, gjithsecili prej jush këtu jeni në dijeni se më 09 shtator 2020 e keni marr një vendim për ta kaluar këtë propozim rregullore për diskutim publik, realisht ju e keni marrë atë vendim por njëkohësisht debatet publike i keni shtyrë për shkak të situatës dhe kushteve pandemike, deri më sot ka kaluar një kohë bukur e gjatë dhe ajo rregullore qëndron në sirtarë, ndoshta nuk ishte dashur të qëndroj aty por po qëndron. Qëllimi jon i vetëm është që kësaj rregulloreje t'i hapim rrugë, duhet të jemi të qartë dhe shumë të vetëdijsëm, nuk po kërkojmë të fillojmë me formimin e komiteteve të fshatrave, por po kërkojmë me hap rrugën e cila e mundëson një gjë të tillë, pas një kohe goxha të

gjatë, dhe kur po e them këtë goxha të gjatë, po e mendoj si propozim që ka qenë që kjo rregullore të dal në diskutim publik nga data 19 të këtij muaji deri me datën 18 qershor 2021, që i bije plot 60 ditë, dhe masat e pandemisë që janë marrë janë deri më datën 18.04.2021, do të thotë që e kemi hequr gjithë këtë kohën e pandemisë dhe nuk e di pse ka arsye të dërgohet edhe dy muaj mbrapa kjo rregullore vetëm për me marrë një vendim për ta organizuar një proces për çka jemi nder komunitet e pakta që nuk e kemi aplikuar ende, madje për këtë mund të ju them hapur se ka edhe vërejtje prej organizatave të cilat merren me këtë çështje. Nuk është me rëndësi a votohet apo jo dhe nuk e kemi asgjë për ngutë këtë punë, edhe pse për ngut mund ta kenë ata që presin të jenë pjesë e këtij procesi, pra janë rreth dy muaj kohë për diskutim publik, pastaj procedurat tjera të cilat janë paraparë me rregullore për ngritjen e komisioneve, këtu e dini që në bazë të përbërjes së komisioneve që kanë për tu formuar dhe që do të jenë pjesëmarrës në këtë proces duhet të jenë nga të gjitha subjektet politike, prandaj nuk është mirë të thuhet dhe as të përmendet çështja se ky apo ai subjekt politik po dëshiron ta bëjë këtë rregullore, madje Ju si Kuvend do të jeni pjesë e vëzhgimit vëzhgimit të këtij procesi, prandaj unë nuk po e shoh shumë të arsyeshme as të diskutohet kaq gjatë, por as që të shtyhet kjo çështje sepse vetëm po kërkohet një pëlqim nga ana juaj që të diskutohet me publikun për një rregullore, jo për formimin e këshillave lokale e as për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave, por për rregullore, dhe kjo është shumë e qartë.

Edhe diçka për të mos ju mbet borxh, Komiteti për Politikë dhe Financa gjithëherë rekomandon, dhe nuk merr vendime, pra është një grup i ngushtë i asamblistëve dhe në bazë të kësaj ashtu siç unë po shohë i bie që nëse ne e respektojmë këtë rekomandim, nuk ua kemi dhënë mundësinë edhe asamblistëve të tjerë të cilët nuk janë pjesë e KPF-së që të shprehen lirshëm për këtë çështje, dhe kjo fundja është individuale kush dëshiron voton kush dëshiron nuk e voton, është kaq e thjeshtë, por rekomandimi i KPF-së që ka ardhë, mendoj se nuk është në rregull që t'i paralizoj asamblistët tjerë që të japin mendimin e tyre.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, i drejtohet drejtorit parafolës z.Bahri Selimi, kur e keni paraparë datën e mbajtjes së debatit në Kuvend këtu në këtë sallë, a ke paraparë ndonjë datë për ta mbajtur debatin publik, nuk po them për lokalitetet por në sallën Kuvendit Komunal. Dy muaj po, nga 19 prill 2021 deri më 19 qershor 2021 ishte kërkesa për të qëndruar në diskutim publik kjo draft rregullore, por a keni paraparë ndonjë datë për debat publik në këtë sallë të Kuvendit të Komunës, apo vetëm në lokalitete.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, theksoi, këtë çështje e kam diskutuar në mbledhjen e KPF-së dhe kam thënë që datat nuk është mirë të caktohen tani sepse duhet të caktohen konform masave të vëna nga ISHKP-ja për mbrojtje nga covid-19 dhe kjo ka qenë arsyeja pse nuk kemi caktuar data ngase bazuar në rregullat që nxjerrën nga IKSH-ja sepse nuk jemi që t'i shkelim ato dhe ta rrezikojmë shëndetin e qytetarëve por jemi për ta mbështetur vënien në diskutim publik të kësaj propozim rregulloreje dhe me ecë përpara, por nëse nuk krijohen kushtet e shtyjmë sërish.

Më datë 18 qershor 2021 është data e fundit që kemi kërkuar të bëhet diskutimi publik, por nëse nuk krijohen kushtet ne më 17 qershor po e thërrasim seancën dhe po e shtyjmë këtë çështje.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, kjo çështje kaluar përmes KPF-së, Komiteti i cili është trupë e Kuvendit që i ka të përcaktuara obligimet dhe kompetencat e veta. Drejtori i DA-së z.Bahri Selimi u përpoq ta sqaroi qëllimin e kësaj propozim rregulloreje, të gjithë e dimë se edhe në kohën që subjekti politik që unë i takoj ka propozuar i kam jap vërejtjet e mia se do të jetë problem për tu implementuar kjo çështje. Sa i përket situatës nga covid-19 për të cilën të gjithë jemi në dijeni, duhet ta kuptojmë një gjë që vendimet rreth masave merren prej nivelit qendror Qeverisë, andaj nëse është aq e rëndësishme kjo rregullore, dhe që po e rregullon krejt materien e pushtetit lokal, jo njëherë por dhjet herë duart po i ngrisim, mirëpo nuk është kjo tema, duhet ta kuptojmë që kjo është sjellë në përmes

KPF-së dhe secili Grup politik jem të përfshirë në KPF-së, përfshirë këtu edhe LVV-në e cila është pajtuar, të paktën në bazë të kësaj situatë që jemi nuk po e shoh të arsyeshme pse të marrim kaq shumë kohë për këtë temë. Edhe më 18 të këtij muaji në qoftë se është nevojë urgjente e që për mendimin tim nuk do të jetë dhe nuk do të jetë atraktive për shumë arsye, jo pse jemi në opozitë por edhe pozitë me qenë këtë qasjen e pagesës së nënkryetarëve të këshillave nesër do të paraqesin shumë telashe, këtë e kam thënë edhe njëherë dhe po e ri përsërisë, ndërsa atë anën e mbajtjes diskutim ligjërata, kompetenca e trupave të Kuvendit të Komunës, pastaj cila është detyra dhe roli i çdo këshilltari nuk besoj i nderuari Kryesues i Kuvendit që duhet t'ju japim hapësirë askujt për diçka që rregullorja e thotë dhe je i detyrueshëm ta respektosh dhe të përfundoj diskutimi rreth kësaj pike sepse në rast se është sjellë nga KPF atëherë të hedhet në votim dhe të deklarohemi të gjithë me votë dhe të përfundoj kjo çështje.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, edhe unë konsideroj se debati rreth kësaj çështje përfundoj, madje edhe u stërgjatë paksa, andaj fillimisht e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, 10 kundër dhe 7 vota të përmbajtura miratohet rendi i ditës sipas Thirrjes dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 06 prill 2021, dhe atë;*

- **Raporti Financiar për vitin 2020 - Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim**
- **Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës**
  - Fillimisht Drejtori i Drejtorisë së Administratës, për shkak të masave të reja anti covid-19 të vendosura nga Qeveria e Republikës së Kosovës, propozoi që diskutimi publik të zgjatë 60 ditë, nga data 19.04.2021 deri më 18.06.2021, ndërsa debatet publike (në Kërpimëh me rrethinë, Batllavë me rrethinë, Lulë me rrethinë dhe tri (3) debate në qytetin e Podujevës) të mbahen brenda kësaj periudhe kurdo që krijohen kushtet dhe mundësitë e mbajtjes së tyre në përputhje me masat e Qeverisë, ku Drejtoria e Administratës të merr për detyrë të caktoj datën, vendin, kohën dhe organizimin e debateve publike, Propozim ky i cili nuk u mbështet, me arsyetimet /shqetësimet e anëtarëve të KPF-së se nuk lejohen debate dhe tubime publike me qytetarë dhe nuk mund që paraprakisht të përcaktohet koha se kur mund të zhvillohen debatet publike.
  - Pas situatës së lartcekur, në propozim dhe dakordim të anëtarëve të KPF-së, Njëzëri kjo pikë rekomandohet të shtyhet për një kohë të pacaktuar, varësisht situatës së krijuar nga Pandemia covid-19.
- **Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**
- **Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**
- **Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**
- **Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

- **Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

*Njëzëri, në pako, i rekomandohen, Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimeve përkatëse për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, përfshirë edhe propozim vendimet për formimin e komisioneve vlerësuese për pronat përkatëse dhe se emrat e anëtarëve të propozuar të bëhen në mbledhjen e Kuvendit*

- **Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës**

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe formim të komisionit përkatës sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe se emrat e anëtarëve të komisionit të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.*

- **Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.*

**z.Fatmir Gashi**, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës, do të thotë që kjo propozim rregullore shtyhet për njëherë tjetër për shkak se në mbledhjen e KPF-së është rekomanduar që të shtyhet për një seancë tjetër të radhës varësisht rrethanave dhe situatës së krijuar nga covid-19, gjë e cila u mbështet dhe u miratua edhe tani.

#### **1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më 05 mars 2021 dhe 10 mars 2021**

**z.Fatmir Gashi**, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka dikush të shtoj rreth këtyre procesverbaleve i hedh në votim.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, ka të bëjë me një lëshim të vogël teknik në procesverbalin e datës 10 mars 2021, me saktësisht në faqen 9 – rreshti 21 është një fjalë të cilën unë e kam theksuar ndryshe por që është shkruar ndryshe, përkatësisht unë kam thënë “*përveç tjerash me qëllim të ndërtimit të shpirtit konkurrues*”, kurse në procesverbal është shkruar “*të shpirtit inkorporues*” e që i është humbur kuptimi fjalisë, andaj kërkoj të korrigjohet.

*Njëzëri miratohen procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 05 mars 2021, përfshirë edhe korrigjimin sipas asaj që e paraqiti këshilltari parafolës.*

#### **2. Raporti Financiar për vitin 2020**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-DBF, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, paraqitja e raporteve financiare është një obligim ligjor i Ekzekutivit të Komunës që të raportoj në baza periodike 3 mujore, si dhe paraqitja e raporti të përgjithshëm financiar për vitin përkatës fiskal siç është rasti sot ku paraqitet raporti financiar i Komunës së Podujevës për vitin 2020, raport i cili përfshin informatat në lidhje me shumën e buxhetit fillestar të

aprovuar, shpenzimet kapitale, shpenzimet për mallra dhe shërbime, shpenzimet për subvencione, të hyrat vetanake, suficitin e buxhetit etj.

Shuma totale e buxhetit fillestare të aprovuar për vitin 2020 është sipas strukturës së paraqitur në vijim, paga dhe mëditje janë 13,929,991.00€, mallra dhe shërbime janë 2,318,773.00€, shpenzimet komunale janë 415,000.00€, subvencione 660,050€, dhe shpenzimet kapitale 9,432,455.00€, duke përfshirë këtu edhe klauzolën e investimeve që është 2,670,000.00€, klauzolë kjo e cila ka të bëjë me kredinë e marrë nga Komuna e Podujevës për ndërtimin e kolektorit të ujerave të zeza.

Performanca e shpenzimeve është sipas kësaj strukture të cilën po e paraqes në vijim; shpenzimet buxhetore për vitin 2020 kanë arritur shumën 24,798,321.00€ apo 90.5 % e buxhetit të alokuar që ka qenë prej 27,400,835.00€, nga grandi qeveritar janë shpenzuar 20,457,169.00€, nga të hyrat vetanake 1,358,954.00€, nga donatorët e brendshëm janë shpenzuar 190,557.00€ dhe nga donatorët e jashtëm 69,930.00€, nga huamarrja janë shpenzuar 185,183.00€ dhe nga klauzola e investimeve siç e cekem edhe më lartë janë 2,616,508.00€, shpenzimet për paga dhe mëditje kanë shënuar vlerën prej 12,183,282.00€ apo 99.18% të shumës së buxhetit të alokuar në këtë kategori ekonomike që kanë qenë 12,283,258.00 €, nga grandi qeveritar janë shpenzuar 11,924,422.00€ dhe nga të hyrat vetanake 116,418.00€, pastaj shpenzimet për mallra dhe shërbime gjatë vitit 2020 kanë qenë 2,228,095.00€ apo 69.28% të shumës së alokuar prej 3,215,962.00€, nga grandi qeveritar janë shpenzuar 2,203,928.00€ dhe nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 22,349.00€, shpenzimet për komunalitë kanë arritur 326,745.00€ që do të thotë se janë shpenzuar 86.85% të buxhetit të alokuar në këtë kategori ekonomike, mandej kemi shpenzimet për subvencione dhe transfere që kanë shënuar vlerën prej 1,122,703.00€ ose 89.94% e buxhetit të alokuar që ka qenë 1,248,192.00€ shumë nga e cila janë shpenzuar 959,792.00€ nga grantet ndërsa 752,944.00€ nga të hyrat vetanake. Shpenzimet komunale gjatë vitit 2020 kanë qenë 8,937,496.00€ apo shprehur me përqindje 86.97% e buxhetit të alokuar për këtë kategori ekonomike që ka qenë 10,275,930.00€ shumë nga e cila janë shpenzuar 5,648,290.00€ nga granti 567,780.00€ nga të hyrat vetanake.

Informatat tjera sa i përket buxhetit për vitin 2020 e që duhet të paraqitet para Kuvendit të Komunës besoj që janë pjesë e shfletuesit dhe se nga buxheti i vitit 2020 mjetet që kanë mbetur të pa shpenzuara janë si në vijim, nga granti qeveritar kanë mbetur 1,977,607.00€ mjete të cilat nuk kthehen mbrapa apo siç jemi në dijeni janë mjete të cilat i kthehen buxhetit të nivelit qendror apo si mund të themi janë mjete të humbura për buxhetin e Komunës, pastaj nga të hyrat vetanake kanë mbetur 669,155.00€ të cilat do të barten në vitin 2021 e që besojmë se në mbledhjen e ardhshme të asamblesë komunale do ta kemi në rend të ditës meqenëse për këtë mbledhje për shkak të mos barazimit të bilancit nga Ministria e Financave nuk kemi qenë të gatshëm t'i sjellim me kohë edhe pse tani është e gatshme mirëpo nuk kemi mundur t'i respektojmë këto afatet kohore të cilat nevojiten për mbledhjen e Kuvendit, nga donatorët e brendshëm kanë mbetur 92,355.00€, besoj që është e rëndësishme që të paraqitet edhe performanca e të hyrave vetanake. Plani vjetor i të hyrave vetanake ka qenë për vitin 2020, 1,416,561.00€ dhe të realizuara janë 1,119,337.00€ apo 79% e planit që ka qenë i planifikuar nga të hyrat vetanake. Pra këto ishin disa pika të shkurtra të cilat i janë të paraqitura edhe në raport financiar e që sigurisht raportin e detajuar e keni secili para vetës dhe e keni marr me kohë kështu që vërejtjet dhe sugjerimet e juaja i presim.

**znj.Dorontina Hasani**, theksoi, ne LVV vazhdimisht i kemi analizuar raportet financiare dhe kemi jap kritikën tona se tek një raport financiar të mirëfilltë vije kur menaxhohet paraja publike siç duhet, e sidomos kur duhet të ketë transparencë. Siç jemi në dijeni raportet financiare nuk votohen, sepse buxheti që është shpenzuar dhe mënyrat se si janë shpenzuar nuk mund të kthehen mbrapa. E vetëdijshme që nuk i kemi personat adekuat ku do të mund t'i paraqisnim këto kërkesa dhe vërejtjet tona për këtë raport, por besoj që qeverisja tani duhet të fillojë t'i përmirësojë gjitha këto që janë bërë

deri më tani, performancën e shpenzimeve qysh e shprehu në raport edhe drejtori parafolës, e që është e dobët edhe në këtë vit sikurse në vitet e kaluara, kemi tepërcë të buxhetit rreth në shumë rreth 2 milion e gjysmë euro, (rreth 1,977,000.00€) nga granditë qeveritarë që ka mund të jenë projekte të ndryshme për qytetarët llapjanë, madje këtë nuk do ta meritonin edhe qytetarët llapjanë, por për këtë jemi dëshmitarë të gjithë që vazhdimisht në raportet 3 mujore i kemi paralajmëruar se do të këtë tepërcë të buxheti, tepërcë kemi edhe tek pagat dhe mëditjet ku do të duhej të ishte shifra e saktë, por mos rregullimi i koeficientëve për punëtorët që vazhdimisht është problem dhe që mendoj që duhet të merret seriozisht dhe duhet secili punëtorë ta këtë trajtimin e merituar. Po kaloj tek projekti “Vrella e Revuqit” vazhdimisht që shumë vite barten para të cilat qytetarët i kanë dhënë për atë projekt, si dhe ndaj këtij projekti kanë qenë jo korrekte që nga fillimi e kanë vazhduar gjerë më tani. Pastaj kemi shpenzimet sipas kodeve e që kodet më interesante janë kodi 1330-shërbimet postare, rriten vazhdimisht që dy vite radhazi andaj a mund ta dimë se çka është në pyetje ky shpenzim, sepse është e qartë se ka rritje vazhdimisht në këtë kategori, nuk e di ndoshta drejtori i DBF-së mund të na sqaroj, mandej për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillore janë shpenzuar 2,570.00€ nëse keni njohuri si Ekzekutiv, a mund të na informoni se për çka saktësisht ka qenë ky shpenzim, pastaj kemi kodin për shërbime kontraktuese tjera i cili është rritur nga 439,000.00€ në 363,000.00€ çështje për të cilën po ashtu kërkohet një sqarim se çka ka marr pjesë në këtë kategori, gjithashtu tek kodi i shërbimeve teknike nga 9,700.00€ janë rritur në 56,000.00€, pastaj kemi diçka të dyshimtë tek regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, për regjistrim kemi thuar se vlerën e njëjtë por pak më të lartë se vitin 2019, kurse tek sigurimi kemi një pjesë rreth 3,000.00€ më pak që është një paqartësi e madhe se si mund të ndodh kjo, po ashtu tek kodi reklamat dhe konkurset kemi rritje nga 2,145.00€ në 4,230.00€ për të cilën do të thotë se dihet që ka qenë vit i fushatës dhe mund të jetë e kuptueshme se çka është paguar me këtë kod.

Kemi pyetje edhe për shumë kode tjera, si bartja rutinore, qiraja, pajisjet, reklama, konkurset, drekat zyrtare që ka shpenzime njëjloj si në vitin 2019 edhe pse në vitin 2020 pothuajse pjesën më të madhe kemi qenë të mbyllur për shkak të masave anti-covid-19, këto e shumë gjera tjera shpresoj që do të sqarohen në raportet tjera financiare, por e rëndësishme është se një qytetar duhet të dijë për çdo kod çka përfshin, çka përmban, çfarë lloj shpenzime kanë mund të kushtojnë etj, kështu që presim në raportet tjera financiare të sjellin më shumë me transparencë ndaj qytetarëve të Komunës së Podujevës sepse secili këtu e kemi obligim llogaridhënien ndaj qytetarëve.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket raportit financiar të vitit 2020 nuk kam shumë ndonjë pyetje për drejtorin për arsye se ky raport në pjesën dominante të tij është i qeverisjes së kaluar që paraqet dokumentin me 2 milion euro suficit edhe me 468,000.00€ borxhe për vitin 2020 dhe me një bartje të mjeteve që e ceku edhe parafolësja që për 10-15 vite barten mjetet e projektit të “Vrellen e Revuqit” edhe pse në këtë pikë ndoshta e kisha pasur një pyetje konkrete se çka do të bëhet me këto mjete. Ne kemi kërkuar që nëse Ekzekutivi në të kaluarën dhe në të tashmen nuk ka ndonjë projekt për “Vrellen e Revuqit” që të ju kthehen qytetarëve ato mjete nga participimi që është bërë në atë kohë, dhe mos t’iu mbahen të bllokuara që një dekadë në thesarin e Kosovës dhe të luajnë me ata qytetarë. Sa i përket çështjes së të hyrave vetanake e di që në mesin e vitit të kaluar, për shkaqe të pandemisë ushtruesi i detyrës të kryetarit z.Nexhmi Rudari ka marr një vendim që t’i liroj nga qiraja e shfrytëzimit të pronës publike disa nga qytetarët, dhe nuk është arritur krijimi i të hyrave vetanake. Një pyetje direkte e kam për drejtorin e DBF-se sepse sot jemi me datën 08 prill 2021 dhe në këtë seancë është dashur që të jetë raporti 3 mujore financiare në bazë të planit të punës së Kuvendit, gjë për të cilën ne si opozitë por edhe LVV ka qenë strikt me kërkesën që plani i punës së Kuvendit të zbatohet, prandaj edhe është dashur që raporti 3 mujore janar-shkurt-mars të diskutohet deri më tani në aspektin se çfarë është bërë dhe ku janë shpenzuar mjetet, ndërsa sa i përket planit të kaluar është

e vërtetë se kjo drejtori dhe ky ekzekutiv amnistohet me shumicën e shpenzimeve dhe të gjendjes financiare që ka mbetur për arsye se qeverisja e kaluar ka ditur të arsyetoj raportet financiare me raportet e kaluara, shembull, për derivate, shtypshkronja, qysh ka qenë raportimi i ish drejtorit të DBF-së z.Isuf Latifit dhe mbasi kemi bërë pyetje por nuk kemi marr përgjigje, pastaj kemi arritur që në thesarin e Kosovës të nxjerrim dokumente që pagesat janë bërë në shtypshkronjë për riparim të veturave, kështu që nuk kemi çfarë të diskutojmë për atë të kaluarën e cila ka qenë dhe besoj që i takon ish qeverisjes si pjesë dominante andaj e dimë që si raport dhe si gjendje që kemi afro gjysmë milioni borxhe edhe pse nuk është mbyllur ndoshta viti fiskal dhe bartja e mjeteve financiare dhe 2 milion euro suficit, për gjendjen që e kemi janë shumë. E lus drejtorin e DBF që në të ardhmen por më së largu në seancën e radhës të sjellët raporti financiar 3 muajor, raport i cili është dashur të jetë si pikë e rendit të ditës në këtë seancë.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, edhe në raportet financiare të viteve të kaluara kemi pasur vërejtje për mënyrën e përpilimit të raporteve edhe për mënyrën e paraqitjeve edhe të projekteve, edhe ky raport nuk dallon shumë nga qeverisjet e kaluara dhe secili prej këshilltarëve kemi qenë kundër që buxheti të koncentrohet në urbanizëm dhe në infrastrukture publike, është miratuar duke lënë anash edhe shëndetësinë, arsimin dhe bujqësinë, mirëpo kjo ka qenë politika zhvillimore e qeverisjes së kaluar dhe problemi është që edhe pse i kanë planifikuar në prioritet urbanizmi dhe infrastrukturën publike ata nuk kanë arritur që t'i përfundojnë projektet e planifikuara dhe kemi 2 milion euro suficit, kjo tregon më së miri performancën e qeverisjes së kaluar ku shumë projekte janë realizuar shkel e shko dhe pa mbikëqyrje, disa edhe nuk janë përfunduar ende.

Qeverisja aktuale është dashur që t'i shikoj me kujdes dhe t'i adresoj këto probleme në raportin financiar vetëm po të shikonte listën e kompanive që kanë fituar tender, nuk do koment. Pastaj qeverisja e kaluar ka dështuar edhe në mbledhjen e të hyrave të planifikuara nga tatimi në pronë ku realizmi është arritur 69%, taksa komunale 69%, ndërsa licenca dhe leje ka planifikuar 150,000.00€ kurse ka realizuar vetëm 570,58 €. Obligimet e pa paguara për vitin 2020 në shumë 468,000.00€ ku shumica prej tyre kishin investime kapitale 235,591.00€ është mirë që drejtori i DBF-së të na japë informata rreth këtyre investimeve kapitale të cilat kanë mbetur pa paguar në vitin 2020. Në vitin 2019 kompania “Bini” i ka marr afër 30 kontrata me komunën, ndërsa në vitin 2020 afër 25 kontrata. Gjithashtu kam edhe një pyetje për drejtorin e DBF-së, në këto 3 muaj qeverisje a ka kontraktuar qeverisja juaj ndonjë projekt me kompaninë “Bini” dhe nëse po, sa është vlera nëse ka mundësi.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, nga parafolësit u kërkuar sqarime, ndërsa për sqarime kërkohej edhe dokumentacione shtesë që mundem në seancën e radhës t'i paraqesim, mirëpo ato që tha z.Rafet Llapashtica lidhur me raportin financiar 3 muajor të vitit 2021, dihet që 3 muajori përfundon me 31 mars dhe afati për me i përcjell dokumentacionet në asamblenë komunale pothuajse ka qenë para 31 marsi, dhe normalisht pas datës 31 mars ajo merr kohë edhe pak të përgatitjes së këtij raporti financiar që është raporti i tremujor i vitit 2021, do të thotë që rrjedhimisht kjo është seancë e marsit por që po mbahet në fillim të prillit, prandaj kjo ka qenë arsyeja që nuk kemi mundur ta përcjellim raportin financiar tremujor për vitin 2021, ashtu siç ishte bërë edhe në mbledhjen e KPF-së mirëpo i njëjti sqarim dhe e njëjta arsye është edhe për çështjen e bartjes së mjeteve buxhetore, pra çështja ka të bëjë me lëshimet që janë bërë në nivelin qendror ku nuk ka qenë të konsoliduara pasqyrat financiare nga ana e nivelit qendror, mirëpo tani janë të gatshme gjithçka sa i përket bartjes buxhetore, mirëpo kanë qenë në pyetje dy ditë që ne nuk kemi mund të nxëmë afatin kohorë për të paraqitur si pikë të rregullt në këtë mbledhje, pikë kjo e cila është shumë e rëndësishme bartja buxhetore por që nuk kemi dashur ta procedojmë me procedurë të përsheptuar, mirëpo do të paraqitet në procedurë të rregullt në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Ndoshta me të drejtë nga disa asamblastë u tha që janë mbi 1 milion e 900 mijë euro të cilët kanë mbetur suficit, dhe

në anën tjetër janë rreth 400,000.00€ të cilët në fund të vitit kanë mbetur obligime buxhetore, janë disa arsye për këtë dhe duhet pasur parasysh, dhe t'ju them të drejtën ditën që unë jam emëruar drejtor i DBF më 10 dhjetor 2020 kanë qenë 4 milion euro të pa shpenzuara, sigurisht ato kanë qenë mjete të kontraktuara dhe punë të përfunduara në teren, dhe gjatë asaj periudhe kanë përfunduar punë në shumë afërsisht 2 milion euro projekte të cilat janë proceduar paketë, mirëpo janë disa fatura të cilat kanë ardhur pas datës së përfundimit ligjor të pagesave për të cilat thesari benë pyetje rreth atyre shpenzimeve se a janë mbyllë, shembull me 24 dhjetor 2020, apo 6 ditë para fundit të muajit dhjetor, disa nga ato fatura kanë ardhur pas kësaj date ose në fillim të janarit, prandaj më 31 dhjetor nuk ka mund të përfundohet. Përveç kësaj është edhe një çështje tjetër ku janë rreth 110,000.00€ pagesa të cilat janë kryer nga ana e Komunës së Podujevës, mirëpo Ministria e Financave - Thesari për shkak të bilancit bankar të i cili ka rënë nën nivelin të cilin e parashih Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe i ka kthyer ato mjete, por nuk është problemi vetëm i Komunës së Podujevës, ka qenë problem i shumicës të komunave të cilëve i janë kthyer mjetet buxhetore të cilat janë përfunduar pagesat, ndërkohë që i'u janë kthyer mbrapa nga niveli qendror kjo ka ndodh në fillim të muajit dhjetor me qeverisjen e kaluar por është problemi tek bilanci bankar. Një çështje tjetër që u adresua rreth asaj se cili operator ekonomik ka marr tender, nuk e di ende nuk është lidhë asnjë kontratë sepse është fillimi i vitit derisa të procedohen çështjet, por sigurisht transparenca në Komunë është paraqitur dhe çdo kontratë që ne lidhim dhe çdo procedurë e cila inicohet nga ana e Komunës së Podujevës mund të shihen të gjitha. Diçka që e kemi parë dhe ndoshta keni mundur ta vëreni në web-side të Komunës së Podujevës është një platformë e thjeshtë dhe kuptueshme për të gjithë, kryesisht e kemi bërë për qytetarët sepse ju si asamblistë keni qasje edhe në dokumentacionet tjera dhe i kuptoni shumë më lehtë, pra e kemi quajtur E-shpenzimet sepse çdo faturë e shpenzuara e cila paguhet nga ana e Komunës së Podujevës të paraqitet në web faqen e Komunës, një tabelë e shpenzimeve, operatorët, shuma buxhetore dhe operatorët ekonomike të cilët janë paguar, pastaj nga cili kod buxhetor janë paguar dhe të gjitha informatat tjera që paraqiten në web faqen e Komunës dhe në raportin financiar 3 mujor atë tabelë që ka të bëjë me transparencë kemi për t'ia bashkangjitur raportit financiar, e bashkëngjisim edhe shpenzimet nga bilanci, mirëpo ajo pse i kemi modifikuar në atë formë për arsye se e kemi parë më të thjeshtë dhe më të kuptueshme nga ana e qytetarëve.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, falënderoj parafolësit për kontributin e dhënë rreth kësaj pike, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konsideroj të përmbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

- 1. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë**
  - Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ, theksoi, me lejoni që para jush të paraqes propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Podujevës në fshatin Batllavë, propozim i cili parashihet me nenin 14 i Ligjit nr.06/092 si dhe Rregulloren nr.09/2020, sipas të cilit bëhet fjalë për njësin katastrale parcela nr.02159-0 me sipërfaqe të tërësishme prej 24.587 m<sup>2</sup>, kulturë kullosë klasa e 4, vendi i quajtur “Zllatushë”, Zona kadastrale Batllavë, pronë e Komunës së Podujevës e evidentuar në certifikatën nr.08/942-06007635/20 të datës 16.12.2020.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së cekur më lartë është për qëllime bujqësor, krijimin e mundësive për vende të lira të punës, rritja e të hyrave vetanake të komunës si dhe rritja e vlerës e pronës së komunës.

**z.Florent Hasani**, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së vazhdimisht i kemi mbështetur politikat e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës me qëllim të inkasimit të mjeteve financiare si të hyra për komunën. Sa i përket dhënies në shfrytëzim të pronës në fshatin Batllavë të cilën e paraqiti drejtoresha parafolëse, ne për komision vlerësues propozojmë asamblistin z.Bahri Blakqori.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, ne e dëgjuam drejtoreshën e DPKGJ-se e cila kërkon mbështetje respektivisht për këtë pikë edhe pse këto pikat kanë mund të grumbullohen në një pikë të veçantë pasi që nuk ndryshojnë shumë njëra prej tjetrës. Për anëtarë të komisionit për këtë pikë ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së propozojmë z.Agron Hysenin.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, unë fillimisht deshta prej Ekzekutivi të shoh mënyrën se qysh ka me u zgjedh komision, formulën se si kanë për tu zgjedhur pasi që jemi 3 Grupe të këshilltarëve në këtë Kuvend, a po shkojmë vetëm me tri propozime e pastaj të barten të gjitha votat apo në bazë të fuqisë politike është paraparë që të zgjidhen këto komisione pasi që kërkohen 2 anëtarë të Kuvendit kurse ne jemi 3 Grupe këtu.

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, desha të shtoj edhe diçka, së pari kemi të bëjmë me miratimin ose jo të propozim vendimit, nëse miratohet pastaj diskutohet, propozohen edhe anëtarët e Komisionit e që për secilin vendim duhet të ngritët komision i veçantë, pra ligji e parasheh që Kryetari i Komunës t'i propozoj dy anëtarë nga Ekzekutivi, Kuvendi i Komunës i propozon dy anëtarë nga radhët e Kuvendit si dhe një do të jetë nga organizata joqeveritare.

Sa i përket pyetjes tuaj, pse nuk janë përfshirë të gjitha propozimet në një propozim të vetëm, ju sqaroj se Ligji e parasheh që për çdo pronë të merret vendim dhe për çdo vendim të ngritët komision.

**z.Agim Behluli**, theksoi, kërkoj një sqarim prej drejtoreshës së DPKGJ, për parcelën prej mbi 2 hektarësh ju vetëm e thatë se jepet për çështje bujqësore, mirëpo nëse në atë pronë lejohet të bëhet shtallë duhet me pas parasysh që aty është liqeni shumë afër, prandaj është mirë të specifikohet çfarë planifikohet të bëhet.

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket propozimit për qëllime bujqësore, do të thotë se ligji e parasheh në atë mënyrë për arsye se është kulturë kullosë klasa IV si dhe në listën e veçantë ku parashihen dhënia e pronave në shfrytëzim gjatë vitit 2021 është e propozuar për qëllime bujqësor, dhe ashtu është propozuar.

**z.Agim Behluli**, theksoi, drejtoresha parafolëse e potencoj serish që për qëllime bujqësore, mirëpo pyetja është se a bëhet për ndërtim të shatllës apo për çfarë, nuk po specifikohet për çfarë qëllimi bujqësor.

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, përgjigje parafolësit, theksoi, pas miratimit paraprak dhe ngritjes së komisionit, pastaj është komisioni ai i cili e vendos njoftimin dhe e përcakton më sakt qëllimin.

**z.Agron Hyseni**, theksoi, kam disa pyetje rreth kësaj çështje pasi që edhe vije nga i njëjti lokalitet, njërën prej pyetjeve në fakt e parashtrij edhe kolegu im z.Agim Behluli, pyetja ime është se ku gjendet kjo parcelë, saktësisht në çfarë gjendje momentale është, dhe a ka gjasa me u shfrytëzua për qëllime bujqësore, a ka dal ndokush prej drejtorisë së DPKGJ-së paraprakisht ta shikoj gjendjen momentale të asaj parcele.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, unë mendoj që sa i përket përzgjedhjes së përfitueseve të pronës ajo është një akt tjetër për të cilën ekziston Ekzekutivi i Komunës, kur njerëzit konkurrojnë për prona ata e ofrojnë edhe projektin, por Komuna duhet të sqaroj për pronën se për çfarë e jap në shfrytëzim,

pastaj janë bazat rregullative sepse siç e tha z.Agim Behluli për qëllime bujqësore, ne e dimë që pronat deri në klasë të 3 ose të 4 nuk e di sigurt, nuk mund të kalojnë në tjetërsim pasi duhet edhe pëlqim nga Ministra e Bujqësisë kur kemi të bëjmë me çështjen e shtallave siç tha edhe kolegu z.Agim Behluli, por është mirë që drejtoresha e DPKGJ nëse mundet dhe e ka gjendjen të skanuar, të na njoftoj me gjendjen e asaj prone, konkretisht për ato që i ngriti paraprakisht këshilltari z.Agron Hyseni. Pastaj edhe për pronat në qytet kërkohen sqarime rreth statusit të tyre, të kaluarën e tyre, shembull a ka qenë ndonjë e dhënë me qira, sa janë borxhet, se a është përfunduar kontrata, a është kthyer prona në gjendje të mëparshme sepse me ligj dhe me rregullore për dhënie në shfrytëzim të pronës publike sqarohet qartë se pas përfundimit të qirasë, qiramarrësi duhet ta kthejë pronën komunës në gjendjen që e ka marr, prandaj nëse është një prej atyre pronave ose lokaleve që tani gjatë debatit drejtoresha do të na njoftojë, unë jam shumë i sigurt që qiramarrësi nuk e kthen pronën në gjendjen që e ka marr sepse ka pas ndërhyrje në një lokal. Kështu që nëse pronat në fjalë janë propozuar për dhënie me qira vetëm pse dikush prej atyre lokaliteteve ka ardh në Drejtori dhe kane thënë është një pronë qatje 2 hektar, ne e ndalim këtu këtë çështje/pikë, nëse vet drejtoresha nuk e din, shembull, për këtë pronë që po diskutohet, duhet të thuhet janë 2 hektar, NN lagjja, numri kadastral, fshatin Batllavë, me planin aktual në fuqi të Komunës parashihet që ajo pronë mund të shfrytëzohet për këtë apo atë qëllim, pra e them që Ekzekutivi i Komunës duhet të jetë shumë strikt në këtë drejtim, mirëpo nëse nuk ke përgjigje drejtoresh atëherë i lëmë këto pika për seancën tjetër, përgatitesh me të gjitha të dhënat dhe i kalojmë.

Ne jemi për t'i dhënë pronat komunale me qira por nëse nuk ka të dhëna dhe nuk ka përgjigje konkrete nuk kemi qysh t'i kalojmë, do të thotë është mirë që drejtoresha për secilën pronë të na njoftojë më detajisht sepse ju ndoshta i keni por me na njoftua edhe neve me statusin e pronës dhe ne pastaj i kalojmë si pika. Atë që e tha drejtoresha që fillimisht të miratohen ose jo këto propozim vendime e pastaj të jepen propozimet për anëtar të komisioneve si procedurë pajtohem se është më lehtësuese.

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, materialet të cilat i kemi proceduar në zyre ligjore kanë qenë propozim vendime, certifikata të pronësisë në të cilat evidentohen qartë që është pronë e komunës, edhe në web faqe është evidentuar qartë numri i njësisë kadastrale, kopja e planit si dhe gjithashtu për ta pasur më të lehtë ju që të orientoheni janë edhe fotot së bashku me dokumentet tjera. Parcela në fjalë ka buruar nga lista e veçantë e pronave të cilën e kanë përgatit sektori i pronës i DPKGJ-së. Sa i përket pyetjes rreth destinimit të pronës në fjalë për bujqësi, ashtu ka qenë e përcaktuar në listën e veçantë për arsye se është në kulturë kullosë me klasë të 4.

**z.Agron Hyseni**, theksoi, për procedura administrative ne nuk kemi vërejtje, por gjendja e asaj prone është e pa shfrytëzueshme e më së paku mund të shfrytëzua për bujqësi për shkak se gjendet në atë pjesë ku është pjesa e shtratit të lumit që del prej liqenit të Batllavës dhe nuk ka vit që nuk e merr uji atë pjesë dhe që nuk ka vërshime në atë pjesë, momentalisht rreth 70% e asaj prone është e mbuluar me ujë për shkak të vërshimeve dhe teprica e ujit në liqenin e Batllavës kalon nga ajo pronë, prandaj për qëllime bujqësore më së pakti mund të përdoret ajo pronë, madje për gjendjen momentale të asaj prone unë këtu e kam edhe një foto që e kam bërë dje dhe mund ta shikoni gjendjen (*tregon fotografjin*). Nëse do të propozohet për tu dhënë në shfrytëzim për qëllime ndërtimore për 15 vite, mendoj që do të ishte afat i vogël për cilindo person që investon aty, prandaj në këtë gjendje të asaj prone është e pa arsyeshme të jepet në shfrytëzim.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sa i përket pyetjeve rreth pronës në fjalë, konsideroj që në rast se është pronë e shtratit të lumit, duhet pasur kujdes që aty të ndërtohet, nuk guxon të lejohet ndërtim afatgjatë për arsye se aty bëhet derdhja e lumenjve.

**z.Agron Hyseni**, theksoi, nëse kishte me qen ndërtim është çështje një tjetër sepse investohet, mirëpo sa i përket propozimit që ajo pronë të jepet në shfrytëzim për qëllime bujqësore duhet të ndryshohet sepse nuk ka gjasa që ajo pronë të shfrytëzohet për atë qëllim për shkak se çdo vit nga vërshimet në atë pjesë, prona e cekur mbulohet tërësisht, madje madje edhe  $\frac{1}{4}$  asaj prone është e mbuluar komplet me zhavorr, domethënë që nuk është e mundur të shfrytëzohet për qëllime bujqësore.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, ne po e kuptojmë edhe qëllimin që drejtoresha e DPKGJ-së e paraqiti para nesh për mbështetje por realisht duke iu referuar edhe materialit nuk e shoh të rrugës që ajo pjesë të destinohet në fushën e bujqësisë, domethënë jeni ju ata respektivisht ju jeni pushteti që e parashihni se çka konkretisht duhet të bëhet e jo ne, ne mundemi t'ju kërkojmë sqarime, informata shitesë, në rast se nuk kemi informata të bollshme për këtë pikë të rendit të ditës atëherë qëndrimi i Grupit të LDK-së do të jetë kundër. Ne në parim e përkrahim dhe mbështesim sepse qëllimi është për zhvillimin lokal ekonomik, mirëpo në çoftë se ju nuk arrini me akumulua saktë, konkret dhe konciz se çka realisht po jepet ajo pronë duke qenë në dijeni rreth gjendjes së asaj prone që e paraqiti edhe kolegu z.Agron Hyseni pak më herët, gjendje të cilën edhe e shikuam në foto Grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk e voton.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, e shikova me vëmendje foton e prezantuar nga z.Agron Hyseni dhe është e gjitha në rregull ajo që paraqet në anën praktike, mirëpo edhe për atë arsye se çka duhet të shfrytëzohet kjo pronë është e qartë, bujqësi dhe blegtori. kanali që kalon aty nuk është aq i madh sa që t'i mbulojë 2 hektar që gjenden përreth, prandaj ajo mund të shfrytëzohet për bujqësi dhe blegtori dhe mund të gjeneroj të ardhura për Komunën e Podujevës, madje mendoj që është shumë e qëlluar që kjo pronë të shfrytëzohet komplet edhe nga bujku apo blegtori i cili aplikon për atë tokë, mirëpo në anën tjetër duhet të jetë përfituese edhe komuna dhe është në interes publik që prona komunale në përgjegjësi të jepen në shfrytëzim në mënyrë që të gjenerohen të ardhurat të mjaftueshme për funksionim të përgjithshëm.

**z.Agron Hyseni**, theksoi, i nderuar koleg z.Ragip Fetahu, vetëm dua të them që unë isha shumë modest kur e thash që njëherë në vit vërshohet ajo pronë, tani po ju them që minim 3 muaj gjatë kohës së dimrit ajo pjesë është e mbuluar tërësisht me ujë, unë jetoj në atë vend dhe e njohë, është pjesa e poshtme afër murit të liqenit të Batllavës dhe kjo pjesë është e mbuluar tërësisht me zhavorr, nuk mundet me pas as kullosa madje, më vie keq është synim i gabuar.

Në parim ne si LDK të gjitha pronat që jepen në shfrytëzim jemi për t'i mbështetur por jemi për ato prona të cilat sjellin dobi edhe për interes të përgjithshëm edhe për interes të Komunës.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, është e vërtetë që në atë pjesë nuk ka mbetur askush, por meqë vendi është për kullosë, ai që do ta marr me qira e klasifikon se a i duhet ajo pronë apo jo, kështu që ne në parim jemi që ta mbështesim dhe të kaloj ky propozim, pastaj është çështje e procedurave nëse dëshiron ta marr dikush apo jo.

**z.Agim Behluli**, theksoi, sa për sqarim, ajo pronë nuk është e vogël por është shumë e madhe mirëpo ajo pjesa tjetër është jo e mirë, në qoftë se ne e japim në shfrytëzim atë pronë atëherë çka do të bëhet me pjesën tjetër të pronës që është më lartë sepse këtu u sqarua edhe më mirë, madje në atë pjesë ka qenë një projekt i viteve të 80-ta që është përgatitë që të ndërtohen motele, restorante dhe pishina dhe këtë e din mirë kush ka qenë në atë kohë. Në çoftë se ne sot e japim për qëllime bujqësore konsideroj se është jo e duhur sepse nuk mund të jepet për atë destinim ku ai vend është vetëm "shelnje" do të thoja, mirëpo nëse doni ne edhe mund të dalim dhe ta shikojmë sepse është diçka që shihet, në çoftë se ndokush e ka planifikuar të marr me qira atë pronë për qëllime bujqësore kurse të bëjë diçka tjetër ajo është tjetër gjë. Pastaj sa jam në dijeni unë shumica apo rreth 60-70% e asaj prone është pronë e KEK-ut - pjesa prej murit deri tek pjesa që po diskutohet, kështu që pastaj mund

të ketë telashe sepse nuk mundesh me shfrytëzua për kullosa pronën e KEK-ut, pastaj nga të kalojnë ata, nga të dalin, prandaj mos po dalim keq si Komunë në këtë çështje. Pra unë jam për ta lëshuar me qira, qoftë edhe 100 € në muajt sepse ato mjete hyjnë në buxhet të Komunës dhe më mirë pak se sa hiç, mirëpo nuk e konsideroj të duhur këtë propozim.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, aty ekziston një hartë kadastrale ku shihet prona komunale dhe që dallon prej pronave tjera.

**z.Florent Hsani**, theksoi, mendoj që fillimisht do ishte mirë që në fund fare të zgjidhen anëtarët e komisionit vlerësuese, natyrisht pasi që të miratohet paraprakisht dhënia në shfrytëzim e pronave sipas propozimeve në mënyrë që pastaj zgjedhja anëtarëve të komisionit vlerësues të mos stërgjatët.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, mbase të gjitha pronat i kanë specifikat e veta është mirë të shkojmë për secilën një nga një, sepse kjo në fshatin Batllavë dallon prej pronave tjera, nuk janë të gjitha të njëjta, shembull, shembull dikush është kundër për një propozim dhe për, për tjetrin propozim.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, lidhur me atë që dy parafolësit e potencuan, për atë arsye edhe i kemi caktuar si pika të veçanta për secilën pronë veç e veç. Nëse nuk ka dikush çfarë të shtoj e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës.

*Pas votimit, kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, 14 kundër, dhe asnjë abstenime, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë*

**z.Fatmir Gashi**, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani fillojmë me propozimet për anëtar të komisionit vlerësues për pronën në fshatin Batllavë. Propozimet ishin nga radhët e LVV-së z.Bahri Blakqori, nga LDK z.Agron Hyseni, por kërkoj nga drejtoresha e DPKGJ-së përkatësisht nga Ekzekutivi i Komunës të propozoj anëtarët nga radhët e Ekzekutivit dhe shoqërisë civile.

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, në emër të Ekzekutivit propozoj drejtorët z.Bahri Selimi dhe z.Pajtim Balaj, ndërsa nga shoqëria civile po e paraqes aplikacionin e tyre dhe propozojmë për secilin komision nga një anëtar, nëse pajtoheni edhe ju për këtë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, shoqëria civile mbanë takime dhe ata i paraqesin propozimet, nuk guxon as Ekzekutivi as Kuvendi të propozoj emra vetëm ashtu, por ata vet i paraqesin anëtarët e tyre, mbajnë takim dhe i sjellin emrat në Kuvend.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, dëshiroj të bëj vetëm një sqarim të shkurtër, komisioni vlerësues duhet të votohet në përgjegjësi, do të thotë edhe anëtarët prej Ekzekutivit, edhe prej Kuvendit edhe prej shoqërisë civile. Konkursi për kandidat që kanë dashur të konkurrojnë nga shoqëria civile ka qenë publik, janë ata emra të cilët kanë konkurruar dhe të cilët kanë shprehur interesim që të jenë pjesë të komisioneve në fjalë, prandaj edhe ata votohen drejtpërdrejt këtu sepse nuk ka nevojë shoqëria civile me mbajt takim të veçantë për faktin që kane ardh me konkurrencë, drejtoresha e DPKGJ-së tani sigurisht që do t'i propozoj kurse mbetet e Kuvendit t'i miratoj, por është mirë që në secilin komision vlerësues për dhënie në shfrytëzim të secilës prej pronave të propozuara, anëtarët nga shoqëria civile të jenë të ndryshëm, përveç nëse nuk është i mjaftueshëm numri i atyre që kanë konkurruar nga OJQ-të.

Çështja tjetër që dua ta them është për Grupin e këshilltarëve të LDK-së, në çiftë se dilni dhe votoni kundër një propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien e pronës në shfrytëzim, atëherë fare nuk ka logjikë që të propozoni anëtarë në komisionin vlerësues për atë pronë.

Pronat në fjalë nuk janë tonat as të askujt, por janë prona të Komunës, pra nuk janë as të LVV-së, as PDK-së e të LDK-së, por ne si institucion i propozojmë dhe i ofrojmë në dispozicion për dhënie në shfrytëzim, qoftë për bizneset qoftë për persona fizik që mund të jenë të interesuara për të investuar

në Komunën e Podujevës, prandaj nuk po kuptoj cila është arsyeja që tani me ngrit dorën kundër kësaj, më duket e pa logjikshme sepse nuk po e bëjmë për individë ketë, por në interes të qytetarëve dhe sinqerisht nuk është e drejtë dhe nuk është fer të votohet kundër një propozimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim, ndërsa në anën tjetër të kërkohet me qenë pjesë e komisionit verues për atë pronë.

**z.Agron Hyseni**, theksoi, i nderuar Kryetar, ju nuk keni qenë prezent në pjesën kur u mbajtën diskutimet lidhur me këtë çështje, në parim për asnjë propozim të tillë nuk është LDK-ja kundër përveç faktit që në këtë parcele – Battlavë në të cilën gjendja momentale e saj dhe për faktin se ajo pronë nuk mund të shfrytëzohet për destinimin që ju e keni propozuar për bujqësi, pra të jemi të qartë, kjo është arsyeja, nuk jemi kundër për asnjë prej propozimeve tjera që të jepen në shfrytëzim për interes të përgjithshëm edhe për interes të Komunës, por për parcelën në fjalë sigurisht që edhe vetë e keni parë se është një moçal, prandaj edhe konsiderojmë se nuk mund të përdoret për qëllime bujqësore, kjo ishte arsyeja.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, nuk do të thotë që prona për të cilën po diskutohet të përdoret vetëm për qëllime bujqësore, mund të përdoret edhe për nivel tjetër.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës do të thotë emrat e anëtarëve të Komisionit u propozuan nga Kuvendi dhe nga Ekzekutivi, tani mbetet vetëm edhe anëtari nga radhët e shoqërisë civile.

**znj.Bahrie Shatrolli - Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, lidhur me propozimet anëtarëve nga shoqëria civile ju njoftoj se ka qenë njoftimi publik për OJQ-të që të aplikojnë, emrat të cilët kanë aplikuar janë këta:

Nga OJQ “Sundimi i Demokracisë në Kosovë” ka aplikuar Albina Llumnica,

Nga OJQ “Demokracia Fillon Këtu”, ka aplikuar Shemsi Jashari

Nga organizata “Shoqëria aktive pro-aktiv”, ka aplikuar Genc Rashiti

Nga organizata “Toka në Podujevë” ka aplikuar Elisa Durmishi

Nga organizata “Kosova Center of Demokraci”, ka aplikuar Bujar Kosumi

Pra këta janë personat që kanë aplikuar nga organizatat joqeveritare. Nëse me lejohet i kisha propozuar për secilën pronë nga një anëtarë.

Për këtë pikë të rendit të ditës e propozoj z.Shemsi Jashari, nga OJQ “Demokracia fillon këtu.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, pasi që janë propozuar të gjithë anëtarët, e hedh në votim përbërjen e komisionit vlerësues për Propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues për pronën në fshatin Batllavë në këtë përbërje:*

1. Agron Hyseni, nga radhët e Kuvendit të Komunës,
2. Bahri Blakqori, nga radhët e Kuvendit të Komunës,
3. Bahri Selimi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
4. Pajtim Balaj, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
5. Shemsi Jashari, nga radhët e OJQ / sektorit joqeveritar.

**1. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm**  
**- Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me njësinë kadastrale në fshatin Lupç i Poshtëm nr. i parcelës 00495/4 me sipërfaqe 23403m<sup>2</sup>, kulturë livadh klasë e 4, vend i quajtur “Bugurdoll” Zona kadastrale Lupç i Poshtëm, pronë e Komunës e evidentuar në bazë të certifikatës të datës 16.12.2020, kjo pronë propozohet për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim për destinim bujqësor, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të hyrave vetanake të Komunës.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, konsideroj se pak më herët me qëllim të caktuar u lexua keq çështja në fjalë dhe askush nuk ka të drejtë të flasë në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, përveç meje si shef i Grupit. Qëllimi i LDK-së në asnjë pikë nuk ka qenë kundër propozim vendimit që e referoj drejtoresha e cekur, ndërsa rreth argumentimit plotësisht është e drejtë e jona siç është pjesë e asaj që ne duhet të jemi pjesë e komisionit të cilin e propozuam më herët qoftë edhe në komisionin paraprak. Ne në parim e mbështesim këtë propozim vendim por pastaj është edhe dhënia e argumenteve në rast se ka sqarime shtesë nga këshilltarët komunal.

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri i miratohet Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm*

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, **tani** vazhdojmë me procedurën e radhës në kuadër të kësaj pike që është propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues, urdhëroni fillojmë me propozime.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, për këtë pikë të rendit të ditës i japim mundësin Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së që të përfshihen në komision vlerësues dhe të propozojnë një anëtar nga radhët e tyre.

**z.Florent Hasani**, theksoi, për anëtar në këtë komision, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LVV-së propozojmë z.Kasib Bashota.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, nga radhët e Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, anëtar për Komisionin në fjalë e propozojmë z.Bashkim Sylja.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, luteni që të respektohet përfaqësimi gjinor sa i përket përbërjes së komisioneve, të paktën përbërja të jetë 30% e kuotës gjinore.

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, theksoi, në emër të ekzekutivit të Komunës, për anëtarë të Komisionin vlerësues në fjalë propozohen znj.Elhame Kutlllovci dhe z.Pajtim Balaj, ndërsa nga sektori jo qeveritar e propozojmë znj.Albina Llumnica.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se propozimet u paraqiten, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas propozimeve të dhëna.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues për pronën në fshatin Lupç i Poshtëm, në këtë përbërje:*

- 1. Kasib Bashota, nga radhët e Kuvendit të Komunës ,*
- 2. Bashkim Sylja, nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
- 3. Elhame Kutlllovci, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,*
- 4. Pajtim Balaj, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,*
- 5. Albina Llumnica, nga radhët e OJQ / sektorit joqeveritar.*

**5. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm**

**- Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë fjala është për njësinë kadastrale në fshatin Lupç i Poshtëm nr. i parcelës 00209/0 me sipërfaqe 3ha e 8882m<sup>2</sup>, kulturë kullosë klasë e 3, vend i quajtur “Bugurdoll” Zona kadastrale Lupç i Poshtëm, pronë e Komunës e evidentuar në bazë të certifikatës të datës 16.12.2020, kjo pronë jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite për destinim bujqësor, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të hyrave vetanake të Komunës.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare për komision vlerësues e propozojmë znj.Tringa Sfishta.

**z.Florent Hasani**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar për komision e propozojmë z.Ragip Fetahu.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, do të thotë dy parafolësit u deklaruan edhe për nën pikën që pason dhe propozuan emrat për anëtar në Komisionin vlerësues. Edhe përkundër kësaj pyes a ka propozime tjera, nëse atëherë është mirë që të jepen edhe propozimet nga ekzekutivi dhe nga OJQ.

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës për anëtar në Komisionin vlerësues sipas kësaj pike propozojmë z.Bahri Selimi dhe z.Pajtim Balaj, kurse nga sektori jo qeveritar propozoj znj.Elisa Durmishi.

**z.Pajtim Hodolli**, theksoi, sa vërejta unë shumica e pronave që jepen në shfrytëzim janë të destinuara për bujqësi dhe nuk po mund ta kuptojë pse në njërin prej komisioneve vlerësuese nuk është anëtar drejtori i DBPZHR, por vetëm drejtorët e Drejtorive tjera, do të ishte më e logjikshme që drejtori i DBPZHR të ishte pjesë në komisione sepse është njohës më i mirë i kësaj fushe.

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, theksoi, ligji përkatës nuk e specifikon përbërjen e anëtarëve të komisionit vlerësues, andaj ky është propozim vendim i Kryetarit të Komunës.

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, pra deklarimet ishin për propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës por edhe për nënpikën që ka të bëjë me ngritjen e komisionit vlerësues, andaj i hedh në votim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se njëzëri miratohet Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm.*

*Njëkohësisht edhe propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues për pronën në fshatin Lupç i Poshtëm, në këtë përbërje:*

- 1. Tringa Sfishta, nga radhët e Kuvendit të Komunës ,*
- 2. Ragip Fetahu, nga radhët e Kuvendit të Komunës,*

3. Bahri Selimi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
4. Pajtim Balaj, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
5. Elisa Durmishi, nga radhët e OJQ / sektorit joqeveritar.

**1. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës**  
**- Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, po ashtu e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera, theksoi, për këtë propozim vendimi fjala është ish lokalin afarist (ish Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror), me sipërfaqe 76.95m<sup>2</sup>, rr.”Zahir Pajaziti” - sheshi i qytetit, i cilido ndodhet në njësinë kadastrale nr.002858/0, me sipërfaqe të përgjithshme 1258m<sup>2</sup>, sipërfaqe kjo e njësisë në të cilën ndodhet lokali kurse sipërfaqja e lokalit është 76.95m<sup>2</sup>, zona kadastrale Podujevë e evidentuar në certifikatën e pronësisë të datës 16.12.2020.

Qëllimi i dhënie në shfrytëzim të kësaj prone është për qëllime afariste biznesore, krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e të hyrave vetanake dhe rritja e vlerës së pronës së Komunës.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, në parim ne e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe njëkohësisht sikurse në pikën paraprake, për anëtar në Komisionin vlerësues e propozojmë z.Shaban Bajoku.

**z.Florent Hasani**, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së për këtë pikë të rendit të ditës i japim radhën PDK-së që ta propozojë një anëtar për komision vlerësues.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, në parim e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar për komision vlerësues e propozojmë z.Fatmir Rudari.

**znj.Bahrije Shatrolli - Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, theksoi, anëtarët për Komisionin vlerësues nga radhët e Ekzekutivit të Komunës e propozojmë z.Elhame Kutllovci dhe z.Bahri Selimi kurse nga sektori jo qeveritar propozojmë z.Genc Rashiti.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, gjithashtu edhe për këtë pikë pra deklarimet ishin për propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës por njëkohësisht edhe për propozimet e emrave për ngritjen e komisionit vlerësues, andaj i hedh në votim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se njëzëri miratohet Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm. Njëkohësisht edhe propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues për pronën në fshatin Lupç i Poshtëm, në këtë përbërje:*

1. Shaban Bajoku, nga radhët e Kuvendit të Komunës,
2. Fatmir Rudari, nga radhët e Kuvendit të Komunës,
3. Elhame Kutllovci, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
4. Bahri Selimi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
5. Genc Rashit, nga radhët e OJQ / sektorit joqeveritar.

**1. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës**

**- Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, edhe për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera, theksoi, për këtë propozim vendim kemi të bëjmë me lokalin afarist në pronësi të Komunës së Podujevës me sipërfaqe 16m<sup>2</sup>, rr.”Skenderbeu”, i cili ndodhet në njësinë kadastrale nr.00389/1/, Zona kadastrale Podujevë e evidentuar në certifikatën e pronësisë të datës 16.12.2020. Qëllimi i dhënie në shfrytëzim të kësaj prone të këtij lokali është për qëllime afariste biznesore, krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e të hyrave vetanake dhe rritja e vlerës së pronës. **z.Hasan Ajeti**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, në parim ne e mbështesim këtë propozim vendim dhe po ashtu për anëtarë në komision vlerësues e propozojmë znj.Arlinda Kadriu. **z.Florent Hasani**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe anëtar për komision vlerësues e propozojmë z.Haki Rudari.

**znj.Bahrije Shatrolli Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, theksoi, anëtarët e ekzekutivit të Komunës të propozuar për këtë Komision vlerësues janë z.Pajtim Balaj dhe z.Bahri Selimi kurse nga sektori jo qeveritar propozojmë znj.Elisa Durmishi.

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në bazë të deklarimeve të parafolësve e hedh në votim këtë propozim vendim, përfshirë edhe emrat e propozuar për anëtar të komisionit në fjalë.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se njëzëri miratohet Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës. Njëkohësisht edhe propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues për pronën Lokal në qytetin e Podujevës, në këtë përbërje:*

1. *Arlinda Kadriu, nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
2. *Haki Rudari, nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
3. *Pajtim Balaj, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,*
4. *Bahri Selimi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,*
5. *Elisa Durmishi, nga radhët e OJQ / sektorit joqeveritar.*

**2. Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës**

**znj.Bahrije Shatrolli – Mehmeti**, drejtoreshë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave është paraparë në ligjin dhe rregullore përkatëse. Nga Ekzekutivi i Komunës për anëtarë në këtë Komision, propozojmë z.Avni Fetahun dhe z.Driton Veliun, ndërsa nga sektori jo qeveritar propozojmë z.Bujar Kosumi.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, për anëtar të Komisionit në fjalë e propozojmë z.Rafet Llapashticën.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, për anëtar të Komisionit sipak kësaj pike të rendit të ditës e propozojmë z.Adnan Zymerin.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani e kemi edhe propozimet e anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së

paluajtshme të Komunës dhe e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës me propozimet përkatëse, andaj nëse ndokush nuk dëshiron fjalën, e hedh në votim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se njëzëri miratohet Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:*

1. Avni Fetahu, nga radhët e Kuvendit të Komunës,
2. Driton Veliu, nga radhët e Kuvendit të Komunës,
3. Adnan Zymeri, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
4. Rafet Llapashtica, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës,
5. Bujar Kosumi, nga radhët e OJQ / sektorit joqeveritar.

**z.Florent Hasani**, theksoi, i nderuar Kryesues, kolegu këshilltar z.Bahri Blakçori ka kërkuar fjalën për pikën që posa u votua, mirëpo fjala si është dhënë, si e arsyetoni këtë.

**z.Bahri Blakçori**, theksoi, për komisionin në fjalë konsideroj se duhet të shkojmë në bazë të subjekteve politike, përkatësisht në bazë të përqindjeve që kemi. Pas fjalës së shefit të Grupit të LDK-së duhet t'i kalonte Grupit të LVV-së që të jap propozimin e anëtarit nga LVV, kurse Ju i nderuar Kryesues na e pamundësuar neve si LVV të propozojmë anëtarin nga radhët tona.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, propozimi i tretë ishte nga shefi i Grupit të LDK-së z.Hasan Ajeti, unë ju ftova ta merrni fjalën mirëpo nuk vërejta që pati interesim ndokush edhe e hedha në votim sipas përzgjedhjes.

## **9. Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

**znj.Elhame Kutlovci**, drejtoreshë DKRS, theksoi, duke u bazuar në planin e punës të Kuvendit Komunal për vitin 2021 ndër të tjera është paraparë edhe një informatë nga DKRS. Bazuar në fushëveprimin e DKRS-së, në periudhën kohore dhjetor 2020 deri në mars 2021, kanë përfunduar aktivitete të ndryshme në kuadër të planifikimeve dhe objektivave në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Në dhjetor të vitit 2020 është marrë vendim nga DKRS që salla e leximit në bibliotekën e qytetit të jetë e hapur për lexuesit deri në orën 23:00, gjithmonë duke respektuar masat e pandemisë. Është bërë rregullimi i ngrohjes dhe ndriçimit në bibliotekën e qytetit, gjithashtu salla e leximit është pajisur me rrjet të internetit për lexuesit. Biblioteka e qytetit është pasuruar me tituj të ri për lexuesit. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit i ka dhuruar bibliotekës 210 tituj, dega e shoqatës së shkrimtarëve ka dhuruar 130 tituj, DKRS në bashkëpunim me DKA-në, bibliotekës së qytetit i janë dhuruar 650 ekzemplarë librash. Në kuadër të bibliotekës së qytetit është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me arkivave të përgjithshme të Tiranës dhe Komunës së Podujevës dhe kjo marrëveshje është përfunduar. Arkiva historike e Komunës së Podujevës është zhvendosur në ish objektin e Komunës së vjetër. Është formuar këshilli drejtues i teatrit nga 5 anëtarë dhe është rizgjedhur drejtori i teatrit me konkurs të rregullt. Janë iniciuar procedurat e prokurimit për renovimin e palestrës sportive “Hakif Zejnullahu”, dhe renovimin e bibliotekës së qytetit. Është bërë thirrje për subvencione dhe mbështetje financiare në sport, kulturë, rini dhe teatër. Duhet theksuar se gjendja e pandemisë Covid-19 ka ndikuar dukshëm në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive sepse zakonisht aktivitetet e kësaj natyre organizohen me një numër më të madh njerëzish por përkundër gjendjes së pandemisë disa prej aktiviteteve janë duke u zhvilluar por gjithmonë duke i respektuar masat e pandemisë.

**znj. Adelina Stublla**, theksoi, kjo informatë është e mirëseardhur për ne sepse është informatë gjithëpërfshirëse dhe jemi të kënaqur që tash po punohet për të mirën e rinisë dhe vendit tonë e sidomos furnizimi i bibliotekës me ekzemplarë të ndryshëm, zgjatja e kohës së qëndrimit të lexuesve në bibliotekë në mënyrë që të rinjtë llojnë ta kalojnë kohën në bibliotekë duke lexuar. Kam një sugjerim që me kalimin e masave të pandemisë të bëhet ndonjë shfaqje për fëmijët tanë që qëndrojnë në kopshtin e qytetit tonë.

**z. Adnan Zymeri**, theksoi, e dëgjova informatën e drejtoreshës paraprake për të cilën edhe e falënderoj lidhur me aktivitetet e mbajtura nga DKRS, por konsideroj që përveç kësaj është e rëndësishme me pas informatë me listë të detajuar të investimeve kapitale të cilat kanë qenë në realizim gjatë vitit 2020 dhe cilat projekte tjera të investimeve kapitale të DKRS-së janë me prioritet për vitin 2021.

**z. Pajtim Hodolli**, theksoi, subvencionet që i ka ndarë DKRS-ja vitin e kaluar, këtë pjesë e kam kërkuar edhe nga Ekzekutivi i kaluar që të zyrtarizohet shuma se sa para ka fituar secili aplikues. Listat të jenë publike sepse edhe LVV-ja të njëjtë gjë e ka kërkuar vitin e kaluar, mirëpo për çudi as vet nuk e paska respektuar dhe nuk paska publikuar çmimet se sa janë subvencionuar aplikuesit. Nga drejtoresha e DKRS-së prita të na japë një plan konkret se çfarë do të bëjë gjatë këtij mandati për rininë e Podujevës, ta dimë saktë se gjatë këtij viti a parashihet ndonjë aktivitet për rini, kulturë, sport.

**znj. Elhame Kutllavci**, drejtoreshë DKRS, theksoi, për investime kapitale unë vetëm i kam vazhduar punët që kanë mbetë gjysmë nga Ekzekutivi i kaluar dhe nuk kam mundur të ndërhyjë në këtë rast, kemi pas një investim për renovimin e bibliotekës si dhe renovimin e palestrës sportive “Hakif Zejnullahu”, kemi pas një kontratë 2 vjeçare për 5 fushat sportive në 5 fshatra të Komunës së Podujevës, kontratë e cila është në përfundim e sipër. Sa i përket pyetjeve rreth planifikimeve mund t’ju them se kjo është informatë për punën e DKRS-së në 3 muajt e parë dhe nuk është planifikim. Sa i përket subvencioneve, realisht nuk është bërë shpallja publike me çmime por kushdo që dëshiron ne jemi të hapur dhe transparent sepse kanë qenë kriteret përkatëse për shumën minimale dhe maksimale për mbështetje financiare, komisioni ka vlerësuar me ato çmime dhe nëse ju keni interesim mundeni me ardhë dhe me i marrë dokumentet shtesë.

Planifikimet e aktiviteteve për rini, e ceka më herët në fund të informatës që DKRS, është Drejtoria që ndikohet më së shumti nga pandemia Covid-19 sepse gjithmonë aktivitetet organizohen me një numër më të madh të njerëzve dhe në këtë rast ndoshta shumica e aktiviteteve duhet të pezullohen. Aktivitetet që kemi mundësi t’i mbajmë duke i respektuar masat anti Covid-19, shpresoj se do të mbahen.

**z. Ragip Fetahu**, theksoi, raporti është ashtu si është dhe ashtu siç ka qenë gjendja sepse ne e dimë që DKRS ka qenë pjesë e pazareve politike që 20 vite prandaj e kemi këtë gjendje jo të mirë. Atë që e ceku z. Pajtim Hodolli e tha me të drejtë sepse kam qenë pjesë e shoqërisë civile 3 vite dhe e di se si ka shkuar procesi i përkrahjes të OJQ-ve, ka qenë një proces jo transparent dhe mendoj se drejtoresha e DKRS-së në momentin e parë duhet t’i paraqesë çmimet sa janë jep për secilën OJQ, dhe në mënyrë të detajuar të paraqiten projektet të cilat janë përkrahë. Duhet me qenë transparent dhe duhet me ndryshu nga mentaliteti qeverisës i kaluar.

**z. Fatmir Rudari**, theksoi, z. Pajtim Hodolli bëri një pyetje me të drejtë prandaj kam një pyetje për drejtoreshën e DKRS-së, a duhet ne secili me ardhë në zyrë të DKRS-së për me marrë informacione se sa janë përfitues të atyre subvencioneve pasi që në informatë nuk kanë ardhë sepse kjo mënyrë ka qenë edhe në të kaluarën sepse para një viti djali i Agim Veliut e ka një shkollë të futbollit dhe thuhet se ka përfituar 2 ose tre fishë më shumë se të njëjtat shkolla të futbollit.

Prej DKRS-së kam pritë se ka me sjellë në informatë atë qasje apo edhe këto që kanë marrë sot, nëse ka mundësi tregona listën e përfituesve veç e veç.

**znj.Elhame Kutillovci**, drejtoreshë DKRS, theksoi, nuk e di sa dhe si janë përkrahë OJQ-të sepse nuk kam punuar në komision, ka qenë komisioni vlerësues ai i cili i ka ndarë çmimet por për hirë të transparencës nuk është bërë me ndonjë qëllim që të fshihen këto shuma, kështu që në seancën e radhës do t'i publikoj të gjitha çmimet. Nuk kanë pasur mbështetje të madhe, po flasë për sportin sepse janë në përfundim e sipër dhe ka dalë lista përfundimtare, kurse te kultura dhe rinia është në proces së bashku me Teatrin ende nuk kanë përfunduar.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, faleminderit z.Fatmir Rudari sepse këshilltarët kanë të drejtë të kenë qasje andaj është e rrugës që secili drejtor i Drejtorisë përkatëse të jenë transparent lidhur me kërkesat e këshilltarëve.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, mos publikimi i listave na bën të dyshojmë se ka diçka në ato lista.

**znj.Elhame Kutillovci**, drejtoreshë DKRS, theksoi, ejani kush do që dëshiron në zyrë dhe i diskutojmë bashkërisht.

**z.Fatmir Rudari**, përgjigje drejtoreshës parafole, theksoi, ti drejtoresh na premtove që listat do i sjellësh në Kuvend.

**z.Pajtim Hodolli**, theksoi, drejtoresha e DKRS-së pak më parë u thirr në atë që do t'i pezullojë disa aktivitete për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, andaj nuk e shohë të arsyeshme që 35 asamblist të shkojnë dhe të shikojnë listat dhe shumat e përfituesve për secilën OJQ, andaj kërkoj ta publikoni listën, dhe atë për hir të transparencës.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, atë që e ceku z.Pajtim Hodolli është shumë e drejtë se nuk ka nevojë secili prej nesh të shkoj në zyrë të drejtoreshës për të parë listat, andaj kërkoj të bëhet publike ajo listë për secilën OJQ se sa mjete financiare ka përfituar për secili projekt sepse ky mentalitet është që nga pas lufta, por tani duhet të ndryshojë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, e konsideroj të mbyllur me këtë pikë të rendit të ditës.

## 10. Të Ndryshme

**z.Agim Behluli**, theksoi, meqë deri më datën 18.04.2021 janë në fuqi masat e Qeverisë për mbyllje të vendit, është mirë që edhe një herë t'i ndihmojmë qytetarët e Komunës së Podujevës me nga një pako ushqimore dhe higjienike ashtu siç janë ndihmuar vitin e kaluar.

Po ashtu propozoj që të bëhet plotësim ndryshimi i komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në "Lagjen e Dëshmorëve", në fshatin Balloç sepse ne si komision jemi në fazën përfundimtare të ndarjes së shtëpive kurse na mungon një anëtar i komisionit.

**z.Hasan Ajeti**, theksoi, rreth çështjes që e ceku kolegu parafole, iniciues për ndarjen e pakove emergjente për kategoritë përkatëse ka qenë z.Pajtim Hodolli. Nëse nuk gabo ky propozim ka qenë para 2-3 seancave dhe dua të di se ku ka mbet kjo çështje, e them këtë sepse është premtuar nga Ekzekutivi që në seancën e ardhshme do të merret, respektivisht do të sjellët një propozim vendim, mirëpo deri më sot një vendim i tillë nuk është marrë dhe kjo lidhet drejtpërdrejtë me kërkesën që e ceku kolegu z.Agim Behluli.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, çështja në fjalë, sa kujtoj unë ka mbete ka mbet që në konsultim me shefat e Grupeve me gjet mundësit financiare së bashku me drejtorin e DBF-së për t'i ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike kategori të cekura.

**z.Kasib Bashota**, theksoi, është një kërkesë e personave me nevoja të veçanta të cilët e kërkojnë një të drejtë legjitime të tyre që t'ju rezervohen dy vend parkingje, andaj kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës të merret me këtë çështje sepse më kanë shkruar 5 apo 6 persona me nevoja të veçanta me të cilët jam takuat personalisht, prandaj edhe njëherë të realizohet kjo e drejtë e tyre sepse edhe ata janë pjesë e shoqërisë sonë. Kërkesa ime është që t'ju realizohet kjo e drejtë dhe t'ju lehtësohet kryerja e shërbimeve në mënyrë sa më të lehtë të mundur.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, dua t'i ngrisë dy problematika, e para ka të bëjë me furnizimin me ujë të pijes në fshatrat Metehi, Kërpimëh, Bajçinë, Dobërdol, është më shumë se një dekadë që ka filluar ky projekt dhe qytetarët kanë participuar me shuma të ndryshme, madje ka njerëz që kanë shitë edhe bagëtitë e tyre vetëm që të furnizohen me ujë, andaj pyetja ka të bëjë me DSHPMSh, deri ku ka shkuar ky projekt dhe çfarë mund të bëjë tutje sepse qytetarët e asaj pjese furnizohen me ujë të pijes nga fshati Bajgorë.

Çështja tjetër ka të bëjë me Mullirin në fshatin Pollatë që gjatë luftës ka qenë fabrikë e miellit të misrit dhe kërkoj nga DBPZHR që të shikoj modalitetin dhe mundësitë që të tentojë ta kthejë në funksion edhe kanalin e ujit për këtë mulli sepse janë ndërtuar diga në fshatin Repë dhe Metehi që janë jo funksionale kurse ai mulli është në mëshirën e fatit, fundja mullinjtë janë pjesë e kulturës sonë dhe duhet të kenë trajtim adekuat.

*Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në ora 12:20**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0031653/21**  
**Podujevë,**  
**08 prill 2021**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**